

NJOFTIMI I MODIFIKIMIT TË **KONTRATËS GJATË KOHËZGJATJES SË** **SAJ**

AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR

NJOFTIMI PËR MODIFIKIMIN E MARRËVESHJES KUADËR/KONTRATËS GJATË
ZBATIMIT

1. Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor

Emri Autoriteti Rrugor Shqiptar
Adresa “Rruga Sami Frashëri nr.33”, Tiranë
Tel/Faks +355 4 2234487
E-mail info@arrsh.gov.al
Ueb-faqe www.arrsh.gov.al

2. Kontaktet e personit (ave) përgjegjës për prokurimin:

Emri Eduart Agalliu
E-mail eduart.agalliu@arrsh.gov.al

3. Lloji i procedurës së prokurimit: E Hapur - Mbi kufirin e lartë monetar - Punë publike - prokurim me mjete elektronike

4. Lloji i kontratës / Marrëveshjes kuadër: Realizimi i punimeve

5. Numri i referencës për procedurën / Lotin: REF-02819-08-13-2021.

6. Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër: “Ndërtimi i segmentit rrugor Sheshi Shqiponja - Bulevardi i Ri, Loti 2”

7. Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): - Punime ndërtimi për autostrada, rrugë_45233100-0

8. Fondi limit: 2.485.599.781,248 (Dy miliard e katërqind e tetëdhjetë e pesë milion e pesëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e një presjë dyqind e dyzet e tetë) Lekë pa TVSH
Në Euro: 20,479,523.62 EUR pa TVSH

9. Situata sipas parashikimeve të Nenit 127 të LPP dhe argumentet përkatëse për ta përdorur atë: Bazuar në Nenin 127 të Ligjit Nr. 16/2024 Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) jemi në kushtet e modifikimit të kontratës sipas përcaktimit të këtij neni.

Autoriteti Rrugor Shqiptar ka në zbatim kontratën Nr.7353/7 prot, datë 09.11.2021 me objekt: “Ndërtimi i segmentit rrugor Sheshi Shqiponja - Bulevardi i Ri, Loti 2”, me REF-02819-08-13-2021. Vlera e kontratës është 2,386,175,789.236 Lekë (pa përfshirë vlerën e TVSH-së).

- Afati i kësaj kontrate është 11 muaj nga data e lidhjes së kontratës. Njoftimi për fillimin e punimeve datë 02.12.2021. Punimet janë pezulluar më datë 02.03.2022 dhe kanë rifilluar më datë 01.12.2022, pezulluar më datë 04.01.2023 dhe rifilluar më datë 12.09.2023, raportuar pranë Agjencisë së Prokurimit Publik, konform Udhëzimit nr. 2, datë 18.03.2022 “Mbi Raportimin e Zbatimit të Kontratës”.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me shkresën Nr. 1707/3 prot, datë 18.03.2024 “Detajimi pjesor i buxhetit për shpenzimet kapitale për vitet 2024-2026...” ka miratuar këtë projekt, me detajimin përkatës. Financimi për vitin 2024 është 41,000,000 Lekë me TVSH.

* Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe e Operacioneve me shkresën Nr. 3793 prot, datë 22.05.2024, ka paraqitur relacionin teknik, në të cilin janë paraqitur dhe prezantuar të gjitha shkaqet që kanë çuar në nevojën për këtë modifikim kontrate.

* Mbikëqyrësi i punimeve B.O.E “Transport Highway Consulting shpk & Taulant shpk” me shkresën Nr. extra prot, datë 27.01.2023 administruar pranë ARRSH-së me Nr. 805 prot, datë 27.01.2023 ka përcjellë propozimet e kontraktorit BOE “4 A-M” sh.p.k & “ED KONSTRUKSION” & “I.D.K - KONSTRUKSION” sh.p.k në lidhje me ripunimin e objektit: “Ndërtimi i segmentit rrugor Sheshi Shqiponja - Bulevardi i Ri, Loti 2”.

Propozimet, të cilat janë shqyrtuar dhe miratuar nga Mbikëqyrësi i Punimeve, janë bërë për arsye të mëposhtme:

1. Ndryshime të volumeve për shkak të mospërputhjes së projektit me preventivin.
2. Ndryshime të volumeve dhe përmirësime për shkak të mospërputhjes së projektit me faktin në terren.

Bazuar në Ligjin Nr. 16/2024 Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” Nenin 127, pika 1/b “Modifikim Kontrate” citohet:

“Kontrata publike apo marrëveshja kuadër mund të modifikohet pa zhvilluar një procedurë të re prokurimi në rastet e mëposhtme:

“b) për furnizimin e mallrave, shërbimeve apo kryerjen e punëve në një kontratë që është ende në zbatim nga kontraktori fillestar, të cilat janë bërë të domosdoshme dhe nuk janë përfshirë në dokumentet e tenderit për kontratën fillestare dhe kur zëvendësimi i kontraktorit fillestar:

i. nuk është i mundur për arsye ekonomike apo teknike, sikurse janë kërkesat për zëvendësimin apo ndërveprimin me pajisjen, shërbimet apo instalimet ekzistuese, të prokuruar gjatë procedurës fillestare; si dhe

ii. do të shkaktonte vështirësi të mëdha apo rritje të konsiderueshme të kostove për autoritetin kontraktor.

si dhe Nenit 26 “Modifikimi i Kontratës”, të kontratës bazë, pikat:

26.1 Palët mund të modifikojnë kontratën gjatë afatit të saj, vetëm nëse ndodhen në ndonjë nga rastet e parashikuara në LPP.

26.2 Autoriteti/Enti Kontraktor në çdo kohë, mund të porosisë kontraktorin të bëjë ndryshime brenda qëllimit të përgjithshëm të kontratës në secilin nga elementët e mëposhtëm:

- a) Korrigjime në projektin, vizatimin ose specifikimet e Punëve
- b) Korrigjime në materiale
- c) Korrigjime në sasi

26.3 Kur modifikimi shoqërohet me rritje të vlerës së Kontratës, vlera totale e modifikimeve nuk duhet të tejkalojë 20% të vlerës së kontratës fillestare. Kur kryhen disa modifikime të njëpasnjëshme, ky kufizim duhet të aplikohet për vlerën e përgjithshme të të gjitha modifikimeve. Kur kontrata përmban një klauzolë të rishikimit të çmimit, baza për përllogaritjen e vlerës maksimale të lejuar për modifikimet do të jetë vlera e kontratës me çmimin e përditësuar.

26.4 Asnjë modifikim i Kontratës nuk do të bëhet pa miratimin paraprak të Autoritetit/Entin Kontraktor, shoqëruar me një marrëveshje me shkrim dhe të nënshkruar nga një përfaqësues i autorizuar i Kontraktorit dhe Autoritetit/Entin Kontraktor.

Argumentojmë se ndodhemi në kushtet e modifikimit të kontratës sipas parashikimit ligjor të sipërcituar.

Bazuar në pikën 6 të Nenit 127 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” citohet:

“Arsyet dhe argumentimet për modifikimin e kontratës ose të marrëveshjes kuadër duhet të dokumentohen nga autoriteti ose enti kontraktor”; dhe

në pikën 7 të këtij neni “Në rastet e përmendura në shkronjën “b” të pikës 1 të këtij neni, dokumentimi i modifikimeve duhet të përmbajë një argumentim të të gjitha arsyeve se përse furnizimet, shërbimet ose punët janë të nevojshme, arsyet përse ato nuk janë mbuluar nga kontrata fillestare apo marrëveshja kuadër, si dhe arsyet ekonomike dhe teknike prej të cilave nuk mund të zëvendësohet kontraktuesi fillestar.

Projekti: “Ndërtimi i segmentit rrugor Sheshi Shqiponja - Bulevardi i Ri, Loti 2” i ripunuar konsiston si më poshtë:

Konkretisht:

- Nga progresivi 46-52 rruga kryesore, sipas projektit baze, kontraktori ka hasur ne pengesen e banoreve te zones per realizimin e ketij segmenti rrugor, per kete arsye eshte propozuar qe ky segment se bashku me te gjithe elementet e rruges (mure, shtylla ndricimi, guardrail, shtresa, punime dhe etj) te jete pjese e punimeve jashte kontrates.
- Nga progresivi 26-45 rruga dytesore veri-1, sipas projektit baze, kontraktori ka hasur ne pengesen e banoreve te zones per realizimin e ketij segmenti rrugor, per kete arsye eshte propozuar qe ky segment se bashku me te gjithe elementet e rruges (shtylla ndricimi, guardrail, shtresa, punime dhe etj) te jete pjese e punimeve jashte kontrates.
- Mbikalimi i kembesoreve, si rezultat i hasjes se pengesave te banoreve te zones, e ka pasur te pamundur rezlimin e mbikalimit ne terren, per kete arsye me qellim vijimin e punimeve ne terren, eshte propozuar qe ky element te jete pjese e punimeve jashte kontrates

- Perpos hasjes se veshiteresive ne terren, eshte propozuar qe keto punime te jene pjese e punimeve jashte kontrates edhe per faktin e ecurise se realizimit te punimeve ne kantier sipas radhes teknologjike.

Në total:

Për realizimin e punimeve për përfundimin e punimeve të këtij objekti me ndryshimet e bëra vlera e këtij objektit është: 2,553,212,392.58 Lekë pa Tvsh

Vlera e punimeve sipas projektit të tenderuar: 2,386,175,789.23 Lekë pa Tvsh

Fondi rezervë: 113,627,418.54 Lekë pa Tvsh (përdorur)

Vlera e modifikimit të kontratës: 167,036,603.35 Lekë pa Tvsh

- Vlera e punimeve jashtë kontrate e tejkalon disa herë vlerën e fondit rezervë, fond, i cili është ezauruar për pjesën e punimeve, të cilat janë realizuar në radhë teknologjike më përpara se të lindte nevoja për punimet jashtë kontrate.

Me Vendimin e Këshillit Teknik është vendosur:

Vlera e punimeve që mbeten jashtë vlerës së preventivit të kontratës së tenderuar prej: 167,036,603.35 Lekë pa TVSH të merren në preventivin me objekt: “Ndërtimi i segmentit rrugor Sheshi Shqiponja - Bulevardi i Ri, Loti 2” (Modifikim projekti).

Punimet e përfshira në preventivin “Ndërtimi i segmentit rrugor Sheshi Shqiponja - Bulevardi i Ri, Loti 2” (Modifikim projekti) janë domosdoshmëri të kryhen nga Kontraktori, aktualisht, për shkak të 3 arsyeve:

Punime të ndërthurura me kontratën bazë

Keto punime jane te ndërthurura me punimet e kontratës baze ne mënyre te tille qe e bëjnë te pamundur ndarjen e tyre fizike ne terren. Prandaj, ne gjykimin tone, keto punime duhet te kryhen nga kontraktori ekzistues pasi:

Nëse punimet e mbetura jashtë kontrate do te realizohen nga një operator tjetër duhet qe fillimisht te përfundojnë punimet e kontratës baze, te kolaudohet objekti dhe te lirohet sheshi i ndërtimit për te bere te mundur fillimin e punimeve nga operatori tjetër, pasi nuk mund te punojnë njëkohësisht dy operatore ekonomike ne te njëjtin shesh ndërtimi.

Kjo gjë nuk mund te ndodhe sepse punimet janë te ndërthurura me njëra tjetrën dhe kryerja e punimeve për disa zëra te kontratës baze varet nga realizimi i punimeve te disa zërave te mbetur I jashtë kontratës.

2. Zero kosto për ndërtimin e kantierit.

Kontraktori ekzistues e ka kantierin e ngritur, me mjetet dhe stafin teknik te gatshëm për realizimin e punimeve te mbetura, gjithashtu është i familjarizuar me realizmin projektit.

3. Garant për punimet e kryera.

Nëse punimet e mbetura do te realizohen nga një operator tjetër do te kemi rritje te kostos dhe zgjatje te afatit te përfundimit te punimeve për shkak te korrigjimit te defekteve te punimeve te kryera me pare. Ndërsa kontraktori ekzistues është vet garant i punimeve qe ka realizuar. Kostoja e ndërtimit

Nuk mundet kurrese qe nje operator të ofertojë më lirë se ai aktual, duke pasur parasysht:

Pavaresisht qe punimet jashte kontrates baze perfshijne segmente shume me te vogla te rruges ne lidhje me segmentin rrugor te kontrates baze, mobilizimi dhe kerkesat qe duhet te plotesoje kontraktori fitues i punimeve jashte kontrate jane te njejta sikurse ato te kontraktorit fillestar, per vete kompleksitetin dhe rendesine e ketij investimi sikurse eshte Ndërtimi i segmentit rrugor Sheshi Shqiponja - Bulevardi i Ri.

Vazhdimësia e kontratave të furnizimit që ka aktualisht kontraktori.

Kosto shtesë që vijnë nga përsëritja e shpenzimeve për ngritjen e kantierit nga kontraktori “i ri”.

Kostot shtesë për mobilizimin e stafit teknik drejtues të punimeve.

Nga sa më sipër, bazuar në Nenin 127 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, jemi në kushtet e modifikimit të kontratës sipas përcaktimit të këtij neni.

a) Autoriteti Kontraktor nuk mund të parashikonte mospërputhjet midis projektit-faktit-preventivit, si dhe nevojave dhe domosdoshmërisë së ndryshimeve në funksion të përdoruesve të rrugës.

b) Të gjitha modifikimet e kryera janë të nevojshme të kryhen në këtë fazë, pasi janë të lidhura ngushtësisht me ndërtimin e trupit kryesor të rrugës. Kryerja e punimeve në një fazë të dytë ose nga një tjetër kontraktor do të ishte teknikisht e pamundur, kryesisht, për nderlidhjen e punimeve me jashte kontrates me punimet e kontrates baze si germime shtresa, mure, sipas propozimeve të ardhura. Këtu mund të përmendim, përfundimin e plotë të shtresave asfaltike, përfundimin e plotë të mureve; punimeve të gërmimit, etj. që është e pamundur të realizohen në një fazë të dytë, apo nga një OE tjetër. Sipas kërkesave të paraqitura nga palët e treta, realizimi i këtyre punimeve mund të kryhet vetëm nga kontraktori fillestar, pasi kemi të bëjmë me ndërthurje punimesh, ku nuk mund të punojnë dy kontraktorë të ndryshëm në të njëjtin kantier ndërtimi.

c) Kontrata shtesë nuk kalon 20% të vlerës së kontratës bazë. Autoriteti Kontraktor vlerëson se kostoja e përgjithshme e këtyre punimeve është (7 %), pasi çmimet e preventivit të këtyre punimeve shtesë mbeten ato të tenderuara në kontratën bazë dhe të negociuara.

Përpos fakteve dhe arsyeve të lartpërmendura, projekti “Ndërtimi i segmentit rrugor Sheshi Shqiponja - Bulevardi i Ri, Loti 2” është realizuar nga nje studio e mirefillte dhe me eksperience ne projektimin e rrugeve. Hartimi i projektit ka zgjatur disa muaj dhe ne kete proces jane angazhuar mjete, instrumente dhe staf teknik nga fusha te ndryshme, si psh: Inxhinier Ndertimi, Inxhinier Gjeoteknik, Inxhinier Hidroteknik, Inxhinier Elektrik, Inxhinier Gjeolog, etj.

Sqarojmë se këto modifikime nuk janë parashikuar në projektin fillestar, për arsyet e mëposhtme:

Sipas ketij projekti, pervec te tjerave do te kryeshin punime si me poshte, të cilat nuk ishin marrë parasysh në lidhje me situatën në fakt:

Objekti realizohet në një zonë të banuar, në disa seksione për të ndërtuar trupin e rrugës duhet që mbushjet e larta të realizohen me skarpatë 1:1,5 duke prekur disa shtëpi të cilat detyrimisht duhet të prishen. Për shmangien e impaktit social-ekonomik (për të eliminuar prishjen apo dëmtimin e tyre) është propozuar të realizohet ndërtimi i trupit të rrugës nga mbushje me skarpatë në mbushje me mure me dhë të armuar dhe perde me pilota.

Nga sek 46÷74 aksi I rruges mbivendoset me keson ekzistues I cili ishte ndertuar per realizimin e shkarkimeve te banesave prane ketij investimi te ri te rruges. Ky keson nuk ishte marre parasysh nga projektin baze, per kete arsye lindi nevoja per spostimin dhe rindertimin e tij me qellim aksesimin dhe mirmbajtjen e vazhdueshme.

Mbilartësimin e linjës elektrike dyfishe 110 kV Tirana 1 – Kashar. Linja elektrike L110-2/2;2/3-Tiranë-1-Kashar, i përket linjave të transmetimit, intersekon rrugën kryesore ne seksionet 51-53. Largësia vertikale e përcjellësit të poshtëm të linjës ajrore ne lidhje me rrugën kryesore është 2.05m. Bazuar në “Rregulloren e Shfrytëzimit teknik të centraleve elektrike, nënstationeve dhe linjave

elektrike të sistemit energjistik”, largësia vertikale e përcjellësit të poshtëm të linjës ajrore për distancën më të madhe, nga ndërtimet inxhinierike dhe pengesat natyrore që trasversohen me linjën, duhet të jetë jo më e vogël se 7 metra për linjat me tension 110 kV”. Kjo rregullore është bere me dije nga OST me shkresën Nr. 1755/1 prot., datë 29.03.2022 (administruar nga ARRSH Nr.4121 prot., datë 30.30.2022) me lëndë “Kthim përgjigje mbi azhornimin e rrjetit elektrik për ndërtimin e unazës së jashtme, Tiranë loti 1-7”. Kjo problematike nuk ishte marre parasysh ne projektin baze. Linjat ekzistuese 20 KV mbivendosen me urën (rrethin) që parashikohet në projekt, mbi rrugën “Dine Hoxha”. Për këtë arsye është propozuar spostimi dhe riorganizimin e 8 Fiderave kabllore 20 kv, N/St. Rajonal, Tiranë në gjatësi të rrethit. Kjo problematikë i është bërë me dije OSSH sh.a me anë të shkresës Nr.544 prot., datë 13.01.2022 (Nr. prot. i kontaktorit). Referuar përgjigjes së kthyer nga OSSH sh.a me shkresë Nr. 132./3 prot., datë 22.02.2023 “OSSH” sh.a aprovon zgjidhjen teknike (korrespondenca është pjesë e dokumentacionit). Kjo problematike nuk ishte marre parasysh ne projektin baze.

11. Vlera totale e kontratës së nënshkruar/marrëveshjes kuadër: 167,036,603.35 Lekë, pa përfshirë vlerën e TVSH-së.

12. Vlera e ndryshuar (nëse është rasti): 2,553,212,392.58Lekë, pa përfshirë vlerën e TVSH-së.

13. Kohëzgjatja e kontratës / Marrëveshjes Kuadër: 11 muaj
Dhe afati i ri (nëse është rasti): 20 muaj

14. Emri dhe adresa e operatorit/ëve ekonomik/ë:

Emri: "4 A-M" sh.p.k & "ED KONSTRUKSION" & " I.D.K - KONSTRUKSION" sh.p.k,
NIPT: K92005016L/ K61625001I/ K51408016J
Adresa: Tirane TIRANE Rruga Artan Lenja Pallati i 4 A-M,
Kontaktet: +355694072707
e-mail: info@4a-m.al

15. Data e nënshkrimit të modifikimit: 27/08/2024

16. Burimi i financimit: Buxheti i Shtetit

17. Informacion tjetër që vlerësohet i nevojshëm nga autoriteti/enti kontraktor: